

# Statistikat e kulturës

## Tremujori IV – 2019

**Tiranë, më 31 Janar 2020:** Numri gjithsej i shfaqjeve kulturore në tremujorin e katërt 2019 është 383 shfaqje, duke shënuar një rritje me 2,7 %, në krahasim me tremujorin e katërt 2018. Në institucionet qendrore të artit dhe kulturës, në tremujorin e katërt 2019 janë regjistruar 71.477 spektatorë, 2,8 % më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në vitin 2019, numri gjithsej i shfaqjeve kulturore është 1.124 shfaqje, 8,9 % më shumë, në krahasim me vitin 2018.

Numri i spektatorëve në vitin 2019 është 223.614, duke shënuar rritje prej 3,1 %, krahasuar me vitin 2018. Pjesëmarrja mesatare në institucionet qendrore të artit dhe kulturës ka rënë me 5,1 %, si në tremujorin e katërt 2019 dhe në vitin 2019, krahasuar me të njëjtat periudha të një viti më parë.

### Institucione qendrore të artit dhe kulturës

Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve gjithsej, me 142 të tilla, 31 shfaqje më pak, krahasuar me tremujorin e katërt 2018.

Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, me 444 shfaqje, 2,8 % më pak, krahasuar me vitin 2018. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë renditet e dyta për numrin më të lartë të shfaqjeve, si në tremujorin e katërt 2019 dhe në vitin 2019. Numri i shfaqjeve të realizuara ka ardhur në rritje, krahasuar me periudhën e mëparshme.

**Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve dhe premierave në institucionet kulturore**

Numri i shfaqjeve/premera	Tr.4-2019	Tr.4-2018	Ndryshimi		Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi vjetor
			tremujor	në %			
Teatri Kombëtar Popullor	51	61	-16,4		157	156	0,6
Teatri Kombëtar Eksperimental	142	173	-17,9		444	457	-2,8
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	68	31	119,4		161	97	6,6
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	89	70	27,1		236	198	19,2
Cirku Kombëtar	33	38	-13,2		126	124	1,6
<b>Shfaqje kulturore/premera gjithsej</b>	<b>383</b>	<b>373</b>	<b>2,7</b>		<b>1.124</b>	<b>1.032</b>	<b>8,9</b>


Në tremujorin e katërt 2019, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor është institucioni me numrin më të lartë të spektatorëve, me 26.567 të tillë, duke shënuar një rritje me 6,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky institucion ka numrin më të lartë të spektatorëve edhe në vitin 2019, me 70.647 spektatorë, 29,8 % më shumë, krahasuar me vitin 2018. Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni i dytë me numrin më të lartë të spektatorëve, për të dyja periudhat në fjalë.

**Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve në institucionet kulturore**

Numri i spektatorëve	Tr.4-2019	Tr.4-2018	Ndryshimi		Viti 2019	Viti 2018	Ndryshimi vjetor
			tremujor	në %			
Teatri Kombëtar Popullor	8.470	10.959	-22,7		34.790	39.503	-11,9
Teatri Kombëtar Eksperimental	20.421	19.892	2,7		64.684	65.989	-2,0
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	26.567	24.873	6,8		70.647	54.438	29,8
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	11.219	9.108	23,2		31.795	22.051	44,2
Cirku Kombëtar	4.800	8.722	-45,0		21.698	34.968	-38,0
<b>Numri i spektatorëve gjithsej</b>	<b>71.477</b>	<b>73.554</b>	<b>-2,8</b>		<b>223.614</b>	<b>216.950</b>	<b>3,1</b>

Numri mesatar i spektatorëve për shfaqje ka pësuar një rënie të lehtë, nga 197 spektatorë për shfaqje, në tremujorin e katërt të vitit 2018, në 187 spektatorë për shfaqje, në tremujorin e katërt 2019. Rënia është në masën 5,1 %. Në vitin 2019, numri mesatar i spektatorëve për shfaqje është 199 spektatorë, nga 210 të tillë, që ishin në vitin 2018.

**Fig.1 Pjesëmarja mesatare e spektatorëve për shfaqje në institucionet kulturore**



**Trashëgimia kulturore**


Numri i vizitorëve gjithsej në muze, kala dhe parqe arkeologjike, në tremujorin e katërt 2019 është 150.634 vizitorë, duke shënuar rritje me 12,6 %, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Nga totali i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë kulturore, 59.020 janë vizitorë në muze, 44.002 vizitorë në kala e monumente të tjera dhe 47.612 janë vizitorë në parqe arkeologjike. Numri i vizitorëve në muze, kala e monumente të tjera, si dhe në parqe arkeologjike, për vitin 2019 është 1.065.081, duke shënuar rritje me 6,7 %, krahasuar me vitin 2018.

**Tab.3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike**

Institucionet e trashëgimisë kulturore	Tr.4-2019		Tr.4-2018		Ndryshimi	
	Tr.4-2019	Tr.4-2018	tr.4-2019	tr.4-2018	tremujor në %	Viti 2019
					Viti 2018	Ndryshimi vjetor në %
Muze	59.020	58.281	1,3	317.826	311.940	1,9
Kala e Monumente të tjera	44.002	38.423	14,5	322.395	308.656	4,5
Parqe Arkeologjike	47.612	37.026	28,6	424.860	377.845	12,4
<b>Vizitorë gjithsej</b>	<b>150.634</b>	<b>133.730</b>	<b>12,6</b>	<b>1.065.081</b>	<b>998.441</b>	<b>6,7</b>

Në tremujorin e katërt 2019, numri gjithsej i vizitorëve të huaj në muze, kala dhe parqe arkeologjike është 74.109, duke shënuar një rritje me 18,9 %, krahasuar me tremujorin e katërt 2018. Në vitin 2019, numri i gjithsej i vizitorëve të huaj në institucionet e trashëgimisë kulturore është 585.350 vizitorë, 13,2 % më shumë, krahasuar me vitin 2018. Gjatë tremujorëve të vitit 2019, në të gjithë institucionet e trashëgimisë kulturore vihet re një përqindje më e lartë e vizitorëve të huaj, krahasuar me tremujorët e vitit 2018, me përjashtim të tremujorit të tretë.

**Fig.2 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike**



**Biblioteka Kombëtare**

Në tremujorin e katërt 2019, numri i shërbimeve të njësive bibliotekare është 25.000 njësi, 5,6 % më pak, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2018. Numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare në këtë tremujor është 32.332, duke pësuar rritje me 35,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në Bibliotekën Kombëtare, në tremujorin e katërt 2019 janë afishuar 1.180 tituj të rinj dhe 4.185 ekzemplarë të rinj.

Numri i botimeve për vitin 2019 është 99.741 botime, duke shënuar rritje me 11,8 %, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, numri i frekuentuesve në Bibliotekën Kombëtare është rritur me 60,7 %, krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2019, si numri i titujve të rinj dhe numri i ekzemplarëve të rinj është rritur.

**Tab.4 Frekuentimi dhe botimet në Bibliotekën Kombëtare**

Treguesit	Tr.4-2019	Tr.4-2018	Ndryshimi		Ndryshimi vjetor në %	
			tremujor në %	Viti 2019 Viti 2018		
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	25.000	26.483	-5,6	99.741	89.212	11,8
Frekuentimi	32.332	23.819	35,7	132.462	82.414	60,7
Vepimtari Kulturore dhe Shkencore	62	108	-42,6	149	269	-44,6
Numri i hyrjeve të reja:						
Numri i titujve të rinj	1.180	1.031	14,5	4.075	2.895	40,8
Numri i ekzemplarëve të rinj	4.185	4.155	0,7	14.933	11.291	32,3

# Metodologjia

Të dhënat e statistikave të kulturës i referohen vetëm institucioneve qendrore të cilat janë në varësi nga Ministria e Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Cirku Kombëtar.

Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet:

MUZE	KALA E MONUMENTE TË TJERË	PARK ARKEOLOGJIK
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik, Apoloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalmos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	Manastiri i Mesopotamit	Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigone
Muzeu Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve " Shtëpia me Gjethe"		

## Përkufizime

*Trashëgimi kulturore* është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t'ua përçuar brezave në të ardhmen si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.

*Muze* është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

*Monument kulture* është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

*Park arkeologjik* është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

*Pjesëmarrja mesatare* e spektatorëve për shfaqje llogaritet me numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.

*Bibliotekat* janë institucione kulturore dhe informuese, që realizojnë hyrje të lirë në informacion në cilëndo formë që ai të jetë depozituar. Ato grumbullojnë, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta që përmbajnë informacion në shërbim të formimit të tyre.

*Frekuentimi* llogaritet me numrin e shërbimeve/materialeve bibliotekare që merr çdo frekuentues i bibliotekës kombëtare.

*Materiale bibliotekare* përfshijnë libra, artikuj, harta, disertacione, dhe materiale audiovizuale.

*Tituj të rinj* përfshijnë ato materiale bibliotekare që hyjnë në bibliotekë gjatë një periudhe referuese.

*Ekzemplarë të rinj* përfshijnë numrin e njësive bibliotekare për çdo titull të ri.